



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 22

Tiranë – E hënë, 13 shkurt 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Ligj nr. 1/2017 datë 26.1.2017	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 2, datë 16.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016””, të ndryshuar.....	1751
Ligj nr. 2/2017 datë 26.1.2017	Për sigurinë kibernetike.....	1751
Ligj nr. 3/2017 datë 26.1.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2010, për projektin “Linja e transmisionit 400 kV Shqipëri–Maqedoni”.....	1757
Ligj nr. 4/2017 datë 26.1.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2016, për projektin “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri–Maqedoni (zgjerim)”.....	1758
Ligj nr. 5/2017 datë 26.1.2017	Për ratifikimin e protokollit për ndryshimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve EFTA.....	1760



LIGJ
Nr. 1/2017

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT NR. 2,
DATË 16.12.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR DISA NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 147/2015,
“PËR BUXHETIN E VITIT 2016””,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit nr. 2, datë 16.12.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016””, të ndryshuar.

Miraturar në datën 26.1.2017

**Shpallur me dekretin nr. 9998, datë 9.2.2017,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 2/2017

PËR SIGURINË KIBERNETIKE¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me direktivën (BE) 2016/1148 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 6 korrik 2016, “Mbi masat për një nivel të përbashkët të lartë të sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit në Bashkimin Europian”. Numri CELEX: 32016L1148, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 194, datë 19.7.2016, faqe 1–30.

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është arritja e një niveli të lartë të sigurisë kibernetike, duke përcaktuar masat e sigurisë, të drejtat, detyrimet, si dhe bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet subjekteve që operojnë në fushën e sigurisë kibernetike.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për rrjetet e komunikimit dhe sistemet e informacionit, cenimi apo shkatërrimi i të cilave do të kishte impakt në shëndetin, sigurinë, mirëqenien ekonomike të qytetarëve dhe funksionimin efektiv të ekonomisë në Republikën e Shqipërisë.

2. Përfshihen nga zbatimi i këtij ligji rrjetet e komunikimeve elektronike dhe sistemet e informacionit që janë objekt i rregullimeve ligjore në fuqi për nënshkrimin elektronik, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara, rrjetet e komunikimeve elektronike dhe sistemet e informacionit që përpunojnë, arkivojnë ose transmetojnë informacion të klasifikuar shtetëror, të cilat rregullohen me ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, si dhe rrjetet e komunikimeve elektronike e sistemet e informacionit, për aq sa parashikohet në legjislacionin mbi komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoriteti Përgjegjës për Certifikimin Elektronik dhe për Sigurinë Kibernetike”, në vijim Autoriteti, është institucioni përgjegjës, i krijuar në bazë të legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik.

2. “CSIRT” është Ekipi i Përgjigjes ndaj Incidenteve të Sigurisë Kompjuterike.

3. “Hapësirë kibernetike” është mjedisi digjital i aftë të krijojë, të procesojë dhe të shkëmbejë informacionin e krijuar nga sistemet, shërbimet e shoqërisë së informacionit, si dhe rrjetet e komunikimit elektronik.



4. “Incident i sigurisë kibernetike” është një ngjarje e sigurisë kibernetike, gjatë së cilës shkaktohet cenimi i sigurisë së shërbimeve ose sistemeve të informacionit e të rrjeteve të komunikimit dhe sjell një efekt real negativ.

5. “Infrastrukturë e rëndësishme e informacionit” është tërësia e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit të zotëruara nga një autoritet publik, i cili nuk është pjesë e infrastrukturës kritike të informacionit, por që mund të rrezikojë apo të kufizojë punën e administratës publike në rastin e cenimit të sigurisë së informacionit.

6. “Infrastrukturë kritike e informacionit” është tërësia e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit, cenimi apo shkatërrimi i të cilave do të kishte impakt serioz në shëndetin, sigurinë dhe/ose mirëqenien ekonomike të qytetarëve dhe/ose funksionimin efektiv të ekonomisë në Republikën e Shqipërisë.

7. “Ministër përgjegjës” është ministri që ka në fushën e veprimtarisë së tij çështjet e teknologjisë së informacionit e të komunikimit.

8. “Operator i infrastrukturës kritike të informacionit” është një person juridik, publik ose privat, që administron infrastrukturën kritike të informacionit.

9. “Operator i infrastrukturës së rëndësishme të informacionit” është një person juridik publik, që administron infrastrukturën të rëndësishme të informacionit.

10. “Rrezik i sigurisë kibernetike” është një rrethanë ose një ngjarje, e identifikueshme në mënyrë të arsyeshme, e cila mund të shkaktojë cenimin e sigurisë së shërbimeve ose sistemeve të informacionit dhe të rrjeteve të komunikimit.

11. “Rrjet i komunikimit dhe sistem i informacionit”, do të thotë:

a) një rrjet i komunikimeve elektronike, në kuptimin e pikës 36, të nenit 3, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”;

b) çdo pajisje ose grup i lidhur ose i ndërlidhur i pajisjeve, nga të cilat, një ose më shumë se një, në bazë të një programi, kryejnë përpunimin automatik të të dhënave digjitale; ose

c) të dhënat digjitale të ruajtura, të përpunuara, të gjetura ose të transmetuara nga elementet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, për qëllim të funksionimit, përdorimit, mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së tyre.

12. “Siguria e informacionit” është sigurimi i konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit.

13. “Siguria kibernetike” është tërësia e mjeteve ligjore, organizative, teknike dhe edukative, me qëllim mbrojtjen e hapësirës kibernetike.

Neni 4

Përpunimi i të dhënave personale

Përpunimi i të dhënave personale, për qëllim të zbatimit të këtij ligji, duhet të kryhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

KREU II

SUBJEKTET PËRGJEGJËSE NË FUSHËN E SIGURISË KIBERNETIKE

Neni 5

Kompetencat e autoritetit përgjegjës në fushën e sigurisë kibernetike

1. Autoriteti përgjegjës ka këto kompetenca në fushën e sigurisë kibernetike:

a) përcakton masat e sigurisë kibernetike;

b) vepron si pikë qendrore kontakti në nivel kombëtar për operatorët përgjegjës në fushën e sigurisë kibernetike dhe bashkërendon punën për zgjidhjen e incidenteve të sigurisë kibernetike;

c) administron raportet e incidenteve në fushën e sigurisë kibernetike dhe siguron ruajtjen e regjistrimit të tyre;

ç) siguron ndihmë dhe mbështetje metodike për operatorët përgjegjës në fushën e sigurisë kibernetike;

d) kryen analiza për dobësitë e konstatuara në fushën e sigurisë në internet;

dh) kryen aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi në fushën e sigurisë kibernetike;

e) vepron në cilësinë e CSIRT-së kombëtare.

2. Autoriteti koordinon veprimtaritë e tij me institucionet e sigurisë dhe të mbrojtjes dhe bashkëpunon me CSIRT-të sektoriale dhe autoritetet ndërkombëtare në fushën e sigurisë kibernetike, nëpërmjet marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Subjekte të tjera përgjegjëse

1. Subjekte të tjera përgjegjëse në fushën e sigurisë kibernetike janë:



a) operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit;

b) operatorët e infrastrukturës së rëndësishme të informacionit.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës, miraton listën e infrastrukturave kritike të informacionit dhe të infrastrukturave të rëndësishme të informacionit, e cila përditësohet të paktën një herë në dy vjet.

Neni 7

Ekipi i Përgjigjes ndaj Incidenteve të Sigurisë Kompjuterike (CSIRT)

1. Ekipet e përgjigjes ndaj incidenteve të sigurisë kompjuterike (CSIRT) përbëhen nga specialistë të fushës së sigurisë kompjuterike pranë çdo operatori që administron infrastrukturën kritike të informacionit.

2. Operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit duhet të kenë të paktën një person përgjegjës për incidentet e sigurisë kompjuterike.

3. Ministri përgjegjës nxjerr udhëzim për metodologjinë e punës, detyrat që duhet të zbatojnë ekipet ose personat përgjegjës dhe kriteret e përgjithshme që duhet të respektojnë operatorët në përzgjedhjen tyre.

KREU III

ADMINISTRIMI I SIGURISË

KIBERNETIKE

Neni 8

Masat e sigurisë

1. Në masat e sigurisë përfshihet tërësia e veprimeve për rritjen e sigurisë së informacionit në sistemet e informacionit dhe disponueshmërinë e besueshmërinë e shërbimeve e të rrjeteve të komunikimit në hapësirën kibernetike.

2. Operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturës së rëndësishme të informacionit janë të detyruar të zbatojnë masat e sigurisë, si dhe të dokumentojnë zbatimin e tyre.

3. Operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturës së rëndësishme të informacionit janë të detyruar të zbatojnë kërkesat e masave të sigurisë gjatë ngritjes së infrastrukturës.

Neni 9

Llojet e masave të sigurisë

1. Subjektet përgjegjëse në fushën e sigurisë kibernetike, të ngarkuara me zbatimin e këtij ligji, detyrohen të zbatojnë masat e sigurisë të natyrës organizative dhe teknike.

2. Masat organizative janë ato të:

a) menaxhimit të sigurisë së informacionit;

b) menaxhimit të rrezikut;

c) politikave të sigurisë;

ç) sigurisë organizative;

d) kërkesave të sigurisë për palët e treta;

dh) menaxhimit të aseteve;

e) sigurisë së burimeve njerëzore dhe aksesit të personave;

ë) ngjarjeve të sigurisë e të menaxhimit të incidenteve të sigurisë kibernetike;

f) menaxhimit të vazhdimësisë së punës;

g) kontrollit dhe auditit.

3. Masat teknike janë ato të:

a) sigurisë fizike;

b) mbrojtjes së integritetit të rrjeteve të komunikimit;

c) verifikimit të identitetit të përdoruesve;

ç) menaxhimit për autorizimin e aksesit;

d) veprimtarisë së administratorëve e të përdoruesve;

dh) zbulimit të ngjarjeve të sigurisë kibernetike;

e) mjeteve të gjurmimit e të vlerësimit të ngjarjeve të sigurisë kibernetike;

ë) sigurisë së aplikacioneve;

f) pajisjeve kriptografike;

g) sigurisë së sistemeve industriale.

4. Autoriteti përcakton me rregullore përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë.

Neni 10

Rreziqet dhe incidentet e sigurisë kibernetike

Operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturës së rëndësishme të informacionit janë të detyruar të marrin masat e duhura për të parandaluar dhe minimizuar ndikimin e rreziqeve dhe incidenteve të sigurisë kibernetike në infrastrukturën e tyre.



Neni 11

Raportimi i incidenteve të sigurisë kibernetike

1. Operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturës së rëndësishme të informacionit janë të detyruar të raportojnë menjëherë pasi zbulojnë incidentet e sigurisë kibernetike pranë Autoritetit.

2. Autoriteti përcakton me rregullore llojet e kategoritë e incidentit të sigurisë kibernetike, si dhe formatin e elementet e raportit për incidentet e sigurisë kibernetike.

3. Në rastet e incidenteve dhe sulmeve ndaj sigurisë kibernetike të institucioneve kushtetuese, atyre të sigurisë dhe mbrojtjes, Autoriteti raporton menjëherë pranë drejtuesve të këtyre institucioneve mbi problematikën dhe masat që duhen ndërmarrë.

Neni 12

Ruajtja e të dhënave të incidentit

1. Autoriteti mban dhe administron regjistrin elektronik të incidenteve të sigurisë kibernetike, i cili përmban:

- a) raportin e incidentit;
- b) të dhëna për të identifikuar sistemin në të cilin ndodhi incidenti;
- c) të dhëna për burimin e incidentit;
- ç) procedurën e zgjidhjes së incidentit dhe rezultatin e saj.

2. Në menaxhimin e incidenteve, që prekin operatorët e përcaktuar në nenin 7, të këtij ligji, me qëllim përcaktimin e rëndësisë së incidentit, duhet të merren parasysh parametrat e poshtëshënuar:

- a) numri i përdoruesve të prekur nga incidenti;
- b) kohëzgjatja e incidentit;
- c) shtirja gjeografike e incidentit, në rast se mund të përcaktohet;
- ç) dëmi financiar, në rast se mund të përcaktohet.

3. Autoriteti, me kërkesë të autoriteteve publike, jep të dhënat e administruara në lidhje me një incident kibernetik, vetëm në rast se kërkesa përputhet me qëllimet e përmbushjes së detyrave të tyre funksionale.

4. Autoriteti mund të vendosë të dhënat e administruara në lidhje me incidentet kibernetike në dispozicion të organizmave që kryejnë rolin e autoritetit në fushën e sigurisë kibernetike jashtë vendit dhe të operatorëve të tjerë që veprojnë në

fushën e sigurisë kibernetike, me qëllim sigurimin e mbrojtjes së hapësirës kibernetike.

Neni 13

Konfidencialiteti i të dhënave

1. Nëpunësit e Autoritetit, që marrin pjesë në zgjidhjen e incidentit të sigurisë kibernetike, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e plotë për të gjitha të dhënat e përpunuara gjatë procedurës së zgjidhjes së incidentit. Konfidencialiteti duhet të ruhet edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me Autoritetin, përveç rasteve të parashikuara në ligj.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit mund të heqë detyrimin për konfidencialitetin e të dhënave.

3. Ministri përgjegjës përcakton rastet dhe kriteret në të cilat hiqet detyrimi i konfidencialitetit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni.

Neni 14

Masat në rast kërcënimi ose incidenti kibernetik

1. Me masa në rast kërcënimi ose incidenti kibernetik kuptohen veprimet e nevojshme, me qëllim mbrojtjen e sistemeve të informacionit apo rrjeteve të komunikimit elektronik ose veprimet, me qëllim zgjidhjen e një incidenti të konstatuar të sigurisë kibernetike.

2. Masat në rast kërcënimi ose incidenti kibernetik janë:

- a) paralajmërimet;
- b) kundërmasat;
- c) masat mbrojtëse.

Neni 15

Paralajmërimet

1. Paralajmërimi është një rekomandim për përballjen me kërcënimin në fushën e sigurisë kibernetike. Në rast se Autoriteti konstaton ose merr dijeni për një kërcënim në fushën e sigurisë, jep paralajmërim.

2. Paralajmërimi u njoftohet subjekteve përgjegjëse në fushën e sigurisë kibernetike, sipas rastit. Paralajmërimi publikohet edhe në faqen e internetit të Autoritetit.

Neni 16

Kundërmasat

1. Kundërmasat janë veprime, me qëllim mbrojtjen nga rreziku kibernetik apo nga incidenti i



sigurisë kibernetike ose veprime, me qëllim zgjidhjen e një incidenti të konstatuar.

2. Kundërmasat ndërmerren nga organet publike, operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturës së rëndësishme të informacionit. Personi përgjegjës në cilësinë e pikës së kontaktit informon menjëherë Autoritetin për zbatimin e kundërmasave dhe rezultatit e tyre.

3. Autoriteti, në zbatim të këtij neni, përcakton kundërmasat, me qëllim zgjidhjen e incidentit kibernetik të sigurisë dhe detyrat e personave përgjegjës.

Neni 17

Masat mbrojtëse të natyrës së përgjithshme

1. Masat mbrojtëse të natyrës së përgjithshme janë masat e bazuara në një analizë të incidenteve të sigurisë kibernetike, tashmë të zgjidhura, me qëllim rritjen e mbrojtjes së sistemeve të informacionit, ose shërbimeve, ose rrjeteve të komunikimit elektronik.

2. Operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturës së rëndësishme të informacionit janë të detyruar të marrin masa mbrojtëse të natyrës së përgjithshme.

3. Operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturës së rëndësishme të informacionit njoftohen për nxjerrjen e masave të natyrës së përgjithshme përmes pikave të kontaktit.

4. Autoriteti nxjerr rregullore për masat mbrojtëse të natyrës së përgjithshme, të cilat publikohen në faqet e internetit të Autoritetit.

Neni 18

Pikat e kontaktit

1. Operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturës së rëndësishme të informacionit caktojnë pikat e kontaktit, sipas përcaktimeve në këtë ligj. Në të dhënat për pikat e kontaktit përfshihen:

a) për personat juridikë: emri, adresa e selisë, numri i identifikimit (NIPT) të personit juridik ose numri i ngjashëm, i caktuar jashtë vendit, dhe të dhënat e personit të kontaktit që është i autorizuar të veprojë në emër të tij;

b) për personat juridikë publikë: emri, adresa e selisë, numri i regjistrimit (NIPT) dhe të dhënat e personit të kontaktit që është i autorizuar të veprojë në emër të tij.

2. Ndryshimet në të dhënat e pikave të kontaktit i komunikohen Autoritetit nga operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturës së rëndësishme të informacionit brenda 7 ditëve kalendarike.

3. Autoriteti mban regjistrin elektronik të pikave të kontaktit me të dhënat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Subjektet përgjegjëse, të përcaktuara në nenin 7, të këtij ligji, janë të detyruara të njoftojnë të dhënat e kontaktit brenda 3 muajve nga data e miratimit të këtij ligji.

KREU IV

GJENDJA E KRIZËS KIBERNETIKE

Neni 19

Kriza kibernetike

1. Gjendja e krizës kibernetike është situata, gjatë së cilës siguria e informacionit në sistemet e informacionit ose siguria e rrjeteve të komunikimeve elektronike është seriozisht e rrezikuar, duke vënë në rrezik interesin publik të Republikës së Shqipërisë.

2. Gjendja e krizës kibernetike shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës, të shoqëruar me relacionin përkatës. Urdhri për shpalljen e gjendjes së krizës kibernetike njoftohet në media.

3. Gjendja e krizës kibernetike shpallet për një periudhë kohore deri në shtatë ditë. Periudha e dhënë mund të zgjatet në mënyrë të përsëritur vetëm pas miratimit të Kryeministrit. Periudha maksimale e shpalljes së gjendjes së krizës kibernetike nuk duhet të kalojë 30 ditë.

4. Gjatë periudhës së gjendjes së krizës kibernetike, ministri përgjegjës informon Kryeministrin në lidhje me zgjidhjen e kësaj gjendjeje, si dhe për kërcënimet reale që çuan në shpalljen e kësaj gjendjeje. Gjatë gjendjes së krizës kibernetike Autoriteti ka të drejtë të nxjerrë vendim ose të marrë masa mbrojtëse të natyrës së përgjithshme dhe kundërmasa.

5. Kur është e pamundur të shmangët një kërcënim ndaj sigurisë së informacionit në sistemet e informacionit ose sigurisë së shërbimeve ose sigurisë dhe integritetit të rrjeteve të komunikimit elektronik, ministri përgjegjës i propozon menjëherë Kryeministrit vendosjen e gjendjes së krizës kibernetike. Kundërmasat e nxjerra nga



Autoriteti para vendosjes së gjendjes së krizës kibernetike mbeten në fuqi për aq kohë sa këto kundërmasa nuk bien në kundërshtim me masat emergjente të deklaruara nga Këshilli i Ministrave.

6. Autoriteti koordinon veprimet e të gjitha strukturave përgjegjëse për zgjidhjen e gjendjes së krizës kibernetike.

KAPITULLI V KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 20 Masat korrigjuese

1. Kur Autoriteti konstaton mangësi në zbatimin e masave të sigurisë, të nxjerra në zbatim të këtij ligji, ai cakton personin përgjegjës për të korrigjuar mangësitë e konstatuara dhe, sipas rastit, cakton masat e nevojshme për t'i eliminuar këto mangësi.

2. Kostot lidhur me zbatimin e masave korrigjuese mbulohen nga operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturës së rëndësishme të informacionit.

3. Autoriteti përcakton një afat të arsyeshëm, brenda të cilit operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturës së rëndësishme të informacionit duhet të marrin masat korrigjuese.

4. Operatorët janë të detyruar të njoftojnë për marrjen e masave korrigjuese brenda afatit të përcaktuar dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesin edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.

Neni 21 Kundërvajtjet administrative

1. Në kuptim të këtij ligji, përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

a) mosraportimi i incidenteve kibernetike, në zbatim të pikës 1, të nenit 11, të këtij ligji;

b) mospërbushja e detyrimeve të caktuara nga Autoriteti, në zbatim të pikës 1, të nenit 13, të këtij ligji;

c) mosraportimi pranë Autoritetit i pikës së kontaktit apo i përditësimeve të tyre, në zbatim të pikës 4, të nenit 18, të këtij ligji;

ç) mospërbushja e detyrimeve të përcaktuara në kuadër të masave korrigjuese, në zbatim të nenit 20 të këtij ligji.

2. Të ardhurat e siguruar nga kundërvajtjet administrative derdhen 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

Neni 22 Sanksionet administrative

Kur Autoriteti konstaton shkeljen e dispozitave, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, sipas nenit 21, të këtij ligji, vendos dënimin me gjobë si më poshtë:

a) nga 200 000 deri në 800 000 lekë, në rast të shkeljeve administrative të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “ç” të pikës 1;

b) nga 20 000 deri në 40 000 lekë, në rast të shkeljeve administrative të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1;

c) nga 40 000 lekë deri në 200 000 lekë, në rast të shkeljeve administrative të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 1.

Neni 23 Procedura

Procedurat e konstatimit, shqyrtimit, ankimit dhe ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative janë ato të parashikuara në ligjin për kundërvajtjet administrative.

Neni 24 Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2, të nenit 6, të këtij ligji, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Ngarkohet Autoriteti të nxjerrë rregulloret përkatëse, në zbatim të neneve 9, pika 4; 11, pika 2; 16, pika 3; 17, pika 4, të këtij ligji, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës të nxjerrë akte nënligjore në zbatim të pikës 3, të nenit 7, dhe të pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 25 Dispozitat kalimtare

1. Për nëpunësit civilë ekzistues të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike zbatohen dispozitat e legjislationit të nëpunësit civil në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.



2. Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike, krijuar me vendimin nr. 766, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike”, të ndryshuar, do të vazhdojë të kryejë veprimtarinë e saj deri në momentin e fillimit të funksionimit të Autoritetit, sipas këtij ligji.

3. Mjetet, burimet e të ardhurave, arkivat, detyrimet dhe kompetencat e Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT) transferohen tek Autoriteti, sipas këtij ligji.

4. Buxhetet e miratuara për Agjencinë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike dhe Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik, sipas ligjit vjetor të buxhetit, do të bashkohen, duke përbërë buxhetin e miratuar të autoritetit përgjegjës.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.1.2017

Shpallur me dekretin nr. 9999 , datë 9.2.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 3/2017

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2010, PËR PROJEKTIN “LINJA E TRANSMISIONIT 400 KV SHQIPËRI–MAQEDONI”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe

Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2010, për projektin “Linja e transmisionit 400 kV Shqipëri–Maqedoni”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.1.2017

Shpallur me dekretin nr. 10000, datë 9.2.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË MBI BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2010 PËR PROJEKTIN “LINJA E TRANSMISIONIT 400 KV SHQIPËRI–MAQEDONI”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë – në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë,

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje,

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

duke iu referuar premimit të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë (notë verbale nr. 157/2010 e datës 7 dhjetor 2010),

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i mundëson Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose një huamarrësi tjetër, i cili do të zgjidhet bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrë për projektin “Linja e transmisionit 400 kV Shqipëri–Maqedoni” nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) një hua me kushte të favorshme, e cila akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, me vleftë prej



deri në 30.000.000 EUR (me fjalë: tridhjetë milionë euro), nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur në kuadër të politikës zhvillimore dhe kur Republika e Shqipërisë vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë dhe kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, në rast se ai vetë nuk është huamarrës. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

2. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

3. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafit 2 do të kthehen në hua, nëse ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis KfW-së dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1, paragrafi 1, zhvleftësohet, kur kontratat përkatëse të huadhënies nuk lidhen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2018.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj KfW-së të gjitha pagesat në euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve në bazë të kontratave, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumave të financimit, do të garantojë ndaj KfW-së pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha tatimet dhe taksat e tjera publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huave dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr sipas rastit lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, në të cilën Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më _____, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave
të Republikës së Shqipërisë

Për Qeverinë e
Republikës Federale
të Gjermanisë

LIGJ Nr. 4/2017

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2016, PËR PROJEKTIN “LINJA E TRANSMETIMIT 400 KV SHQIPËRI–MAQEDONI (ZGJERIM)”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2016, për projektin “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri–Maqedoni”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.1.2017

Shpallur me dekretin nr. 10001, datë 9.2.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË MBI BASHKËPUNIMIN
FINANCIAR 2016 PËR PROJEKTIN
“LINJA E TRANSMETIMIT 400 kV
SHQIPËRI–MAQEDONI (ZGJERIM)”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë,

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë,

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje,

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

duke in referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 12 korrik 2016,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i mundëson Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose një huamarrësi tjetër, i cili do të

zgjidhet bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrë për projektin “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri–Maqedoni (zgjerim)” (PN:2016.6789.8) nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) një hua me kushte të favorshme, e cila akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, me vlerë të përgjithshme deri në 20.000.000 EUR (me fjalë: njëzet milionë euro), nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur në pikëpamje të politikave zhvillimore dhe nëse Republika e Shqipërisë vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë, si dhe kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, në rast se ai vetë nuk është huamarrës. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

2. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në një kohë të mëvonshme, i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis KfW-së dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1, paragrafi 1, zhvlerësohet, kur kontratat përkatëse të huadhënies nuk lidhen brenda vitit aktual. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2016.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj KfW-së të gjitha pagesat në euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve në bazë të kontratave, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumave të financimit, do të garantojë ndaj KfW-së pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen, që



mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha tatimet dhe taksat e tjera publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2 paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e lë në gjykimin e pasagjerëve dhe furnizuesve të zgjedhin lirisht mes ndërmarrjeve transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, që rezultojnë nga dhënia e huave dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr, sipas rastit, lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, në të cilën Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më _____, në dy originalë, secili në gjuhën gjermane dhe shqipe, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

Për Qeverinë e
Republikës Federale të Gjermanisë

Për Këshillin e Ministrave
të Republikës së Shqipërisë

LIGJ
Nr. 5/2017

**PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT
PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES
SË TREGTISË SË LIRË NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE SHTETEVE EFTA**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokollin për ndryshimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve EFTA, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.1.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10002, datë 9.2.2017,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Shpërndarja EFTA/AL

Ref. 14-129501
(më parë 34137)
17 mars 2015

DRAFT

**PROTOKOLLI PËR NDRYSHIMIN E
MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE SHTETEVE TË EFTA-S**

Republika e Shqipërisë (në vijim i referuar si “Shqipëria”), nga njëra anë, dhe Islanda, Principata e Lihtenshtejnit, Mbretëria e Norvegjisë, Konfederata Zvicerane (në vijim të referuara si “Shtetet e EFTA-s”), nga ana tjetër,

në vijim secili shtet individual i referuar si “Palë” ose kolektivisht të referuar si “Palët”:

duke pasur parasysh Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve EFTA, të nënshkruar në Gjenevë, më 17 dhjetor 2009, në vijim të referuar si “Marrëveshja”,

duke pasur parasysh angazhimin e tyre për të ndjekur objektivin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe duke njohur rëndësinë e koherencës dhe mbështetjes së ndërsjellë të tregtisë, mjedisit dhe politikave të punës në këtë drejtim,

duke pasur parasysh diskutimet në mbledhjen e parë të Komitetit të Përbashkët EFTA–Shqipëri të mbajtur në Tiranë, më 5 shkurt 2013, si dhe shkëmbimet pasuese mbi shtimin e një kapitulli për tregtinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Marrëveshje,



duke pasur parasysh nenin 38 të Marrëveshjes,
 Bien dakord për ndryshimet e mëposhtme të marrëveshjes:

1. Teksti i përcaktuar në aneksin I të këtij protokollit do të zëvendësojë PREAMBULËN në tërësinë e tij.

2. Një nënparagraf i ri (c) i shtohet paragrafit 2, të nenit 1 “Objektivat” të Marrëveshjes dhe si pasojë, nënparagrafët pas nënparagrafit të ri (c) do të riemërtohen. Nënparagrafi i ri (c) do të ketë formulimin e mëposhtëm:

“(c) për të zhvilluar tregtinë ndërkombëtare në një mënyrë të tillë që të kontribuojë në objektivin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe për të

garantuar që ky objektiv është i integruar dhe i pasqyruar në marrëdhënien tregtare të Palëve;”

3. Teksti i përcaktuar në aneksin II të këtij protokollit do të shtohet si një KAPITULLI 6 i ri dhe si pasojë, numrat e të gjithë kapitujve dhe neneve ekzistues pas KAPITULLIT të ri 6 do të rinumërtohen.

4. Referimi në “neni 33” në paragrafin 3 të nenit 32 “Konsultimet” të Marrëveshjes do të zëvendësohet nga “neni 43”.

5. Referimi në “kapitulli 7” në nenin 7 të Marrëveshjes Dypalëshe mbi Bujqësinë ndërmjet Shqipërisë dhe Islandës, Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë dhe Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane do të zëvendësohet nga “kapitulli 8”.

6. Referimi në “neni 31” në paragrafin 1 të nenit 1 të Rregullave të Procedurës të Komitetit të Përbashkët EFTA–Shqipëri, të miratuar nga vendimi 1 i vitit 2013 i Komitetit të Përbashkët EFTA–Shqipëri do të zëvendësohet nga “neni 41”.

7. Ndryshimet e mësipërme do të hyjnë në fuqi në ditën e parë të muajit të tretë pas depozitimit të instrumentit të fundit të ratifikimit, pranimit ose miratimit pranë Depozitarit, i cili do të njoftojë Palët e tjera.

8. Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës Europiane të Tregtisë së Lirë do të depozitojë tekstin e këtij Protokollit te Depozitari.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar zyrtarisht për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Protokoll për të ndryshuar Marrëveshjen.

Bërë në [VENDI], më [...] [DATA] në një kopje origjinale në gjuhën angleze që do të depozitohet pranë Depozitarit, i cili do t'i transmetojë të gjitha Palëve kopje të noterizuara.

Për Këshillin e Ministrave
 të Republikës së Shqipërisë

.....

Për Islandën

Për Principatën e
 Lihtenshtejnit.....

Për Mbretërinë e
 Norvegjisë.....

Për Konfederatën e
 Zvicerane.....

ANEKSI I PREAMBULA

Republika e Shqipërisë (në vijim i referuar si “Shqipëria”), nga njëra anë,

dhe Islanda, Principata e Lihtenshtejnit, Mbretëria e Norvegjisë dhe Konfederata Zvicerane (në vijim të referuara si “Shtetet e EFTA-s”) nga ana tjetër,

në vijim secili shtet individual i referuar si “Palë” ose kolektivisht si “Palët”:

duke njohtur dëshirën e përbashkët për të forcuar lidhjet ndërmjet Shqipërisë nga njëra anë dhe Shteteve të EFTA-s nga ana tjetër, duke krijuar marrëdhënie të ngushta dhe të qëndrueshme;

duke rikujtuar qëllimin e tyre për të marrë pjesë në mënyrë aktive në procesin e integritimit ekonomik euro-mesdhetar dhe duke shprehur gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar për kërkimin e mënyrave dhe mjeteve për forcimin e këtij procesi;

duke riafirmuar angazhimin e tyre për demokracinë, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe liritë politike dhe ekonomike, në përputhje me detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut;

duke rikujtuar të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas marrëveshjeve shumëpalëshe mjedisore në të cilat ato janë palë dhe respektimin e parimeve dhe të drejtave themelore në punë, duke përfshirë parimet e përcaktuara në Konventat përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (në vijim referuar si “ONP”) në të cilat janë palë;

duke riafirmuar angazhimin e tyre për të ndjekur objektivin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe duke njohtur rëndësinë e koherencës dhe mbështetjes së ndërsjellë të tregtisë, mjedisit dhe politikave të punës në këtë drejtim;



duke synuar të krijojnë mundësi të reja punësimi dhe të përmirësojnë shëndetin dhe standardet e jetesës në territoret e tyre përkatëse;

duke dëshiruar të krijojnë kushte të favorshme për zhvillimin dhe diversifikimin e tregtisë ndërmjet tyre dhe për nxitjen e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik në fushat me interes të përbashkët mbi bazën e barazisë, përfitimit të ndërsjellë, mosdiskriminimit dhe të drejtës ndërkombëtare;

të vendosur për të nxitur dhe forcuar më tej sistemin tregtar shumëpalësh, të ndërtuar mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre përkatëse sipas Marrëveshjes së Marrakeshit që ka themeluar Organizatën Botërore të Tregtisë (në vijim e referuar si “OBT”) dhe marrëveshjeve të tjera të negociuara më pas, duke kontribuar kështu në zhvillimin harmonik dhe zgjerimin e tregtisë botërore;

duke pasur parasysh që asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të interpretohet sikur i përjashton Palët nga detyrimet e tyre sipas marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare, veçanërisht Marrëveshjes së Marrakeshit që ka themeluar OBT-në dhe marrëveshjet e tjera të negociuara më pas;

të vendosur për të zbatuar këtë Marrëveshje në përputhje me objektivin për të ruajtur dhe mbrojtur mjedisin nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm mjedisor dhe për të nxitur një përdorim optimal të burimeve në botë, në përputhje me objektivin e zhvillimit të qëndrueshëm;

duke afirmuar angazhimin e tyre për shtetin e së drejtës, për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin në tregtinë dhe investimet ndërkombëtare dhe për të promovuar parimet e transparencës dhe qeverisjes së mirë;

duke njohur rëndësinë e qeverisjes së mirë korporative dhe përgjegjësinë sociale korporative për zhvillimin e qëndrueshëm dhe duke afirmuar qëllimin e tyre për të nxitur ndërmarrjet që të respektojnë udhëzimet dhe parimet e njohura ndërkombëtarisht në këtë drejtim, si udhëzimet e OECD-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe, parimet e OECD-së të Qeverisjes Korporative dhe Kompaktin Global të Kombeve të Bashkuara;

duke deklaruar gatishmërinë e tyre për të shqyrtuar mundësinë e zhvillimit dhe thellimit të marrëdhënieve ekonomike, me qëllimin për t'i zgjeruar në fusha që nuk mbulohen nga kjo Marrëveshje;

të bindur që kjo Marrëveshje do të rrisë aftësinë konkurruese të firmave të tyre në tregjet globale dhe do të krijojë kushte që nxisin marrëdhëniet ekonomike, tregtare dhe të investimeve ndërmjet tyre;

kanë vendosur, në ndjekje të sa më sipër, të lidhin Marrëveshjen e mëposhtme (në vijim e referuar si “kjo Marrëveshje”):

ANEKSI II

KAPITULLI 6

TREGTIA DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Neni 31

Konteksti dhe objektivat

1. Palët do të kujtojnë Deklaratën e Stokholmit mbi Mjedisin Njerëzor të vitit 1972, Deklaratën e Rios mbi Mjedisin dhe Zhvillimin të vitit 1992, Axhendën 21 mbi Mjedisin dhe Zhvillimin të vitit 1992, Deklaratën e OBT-së mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë dhe tekstin e saj të rishikuar në vitin 1998, Planin e Zbatimit të Johannesburgut mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm, 2002, Deklaratën Ministeriale të Këshillit Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara mbi Punësimin e Plotë dhe Punën e Denjë të vitit 2006 dhe Deklaratën e OBT-së mbi Drejtësinë Sociale për një Globalizim të Drejtë të vitit 2008.

2. Palët njohin faktin që zhvillimi ekonomik, zhvillimi social dhe mbrojtja mjedisore janë komponentë të ndërvarur dhe reciprokisht mbështetës të zhvillimit të qëndrueshëm. Ata theksojnë përfitimin e bashkëpunimit mbi punën e lidhur me tregtinë dhe çështjet mjedisore si pjesë e një qasjeje globale ndaj tregtisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

3. Palët riafirmojnë angazhimin e tyre për të nxitur zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare në një mënyrë të tillë që të kontribuojë në objektivin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe për të garantuar që ky objektivi integrohet dhe reflektohet në marrëdhënien tregtare të Palëve.

Neni 32

Fusha e veprimit

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë kapitull, ky kapitull zbatohet për masat e miratuara ose të mbajtura nga Palët që prekin aspektet e



punës² të lidhura me tregtinë dhe të lidhura me investimet dhe çështjet mjedisore.

Neni 33

E drejta për të rregulluar dhe nivelet e mbrojtjes

1. Duke njohur të drejtën e secilës Palë, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, për të vendosur nivelet e saj të mbrojtjes mjedisore dhe në punë, dhe për të miratuar ose modifikuar në përputhje me ligjet dhe politikat e saj përkatëse, secila Palë do të kërkojë të garantojë që ligjet, politikat dhe praktikat e saj të parashikojnë dhe të nxisin nivele të larta të mbrojtjes mjedisore dhe në punë, në përputhje me standardet, parimet dhe marrëveshjet e referuara në nenet 35 dhe 36 dhe do të përpiqet të përmirësojë më tej nivelin e mbrojtjes të parashikuar në ato ligje dhe politika.

2. Palët, kur përgatisin dhe zbatojnë masa të lidhura me mjedisin dhe kushtet e punës që prekin tregtinë dhe investimet ndërmjet tyre, njohin rëndësinë e marrjes parasysh të informacioneve shkencore, teknike dhe informacione të tjera dhe standardet, udhëzimet dhe rekomandimet ndërkombëtare përkatëse.

Neni 34

Ruajtja e niveleve të mbrojtjes për aplikimin dhe zbatimin e ligjeve, rregulloreve ose standardeve

1. Një Palë nuk do të dështojë së zbatuari në mënyrë efektive ligjet, rregulloret ose standardet e saj mjedisore dhe të punës në një mënyrë që prek tregtinë ose investimet ndërmjet Palëve.

2. Në bazë të nenit 33 [“E drejta për të rregulluar dhe nivelet e mbrojtjes”], një Palë nuk do të:

a) dobësojë ose ulë nivelin e mbrojtjes mjedisore ose në punë, të parashikuara nga ligjet, rregulloret ose standardet e saj, me qëllimin e vetëm për të nxitur investimet nga një Palë tjetër ose të kërkojë ose rrisë avantazhin konkurrues të tregtisë për prodhuesit ose ofruesit e shërbimit që operojnë në territorin e saj; ose

b) heqë dorë ose ndryshe derogojë ose ofrojë të heqë dorë ose ndryshe të derogojë nga ligje,

rregullore ose standarde të tilla, me qëllim për të nxitur investimet nga një Palë tjetër ose të kërkojë ose rrisë avantazhin konkurrues të tregtisë për prodhuesit ose ofruesit e shërbimit që operojnë në territorin e saj.

Neni 35

Standardet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të punës

1. Palët kujtojnë detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në OBT dhe Deklaratën e OBT-së mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë dhe tekstin e saj të rishikuar, të miratuar nga Konferenca Ndërkombëtare e Punës në Seksionin e saj të 86-të në vitin 1998, për të respektuar, nxitur dhe realizuar parimet në lidhje me të drejtat themelore, specifika:

a) liria e organizimit dhe njohja efektive e të drejtës për negociata kolektive;

b) eliminimi i të gjitha formave të punës së detyruar ose të detyrueshme;

c) heqja efektive e punës së fëmijëve; dhe

d) eliminimi i diskriminimit në lidhje me punësimin dhe profesionin.

2. Palët riafirmojnë angazhimin e tyre sipas Deklaratës Ministeriale të Këshillit Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara mbi Punësimin e Plotë dhe Punën e Denjë të vitit 2006, për të njohur punësimin e plotë dhe produktiv dhe punën e denjë si një element kyç të zhvillimit të qëndrueshëm për të gjitha vendet dhe si një objektiv prioriteti i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe për të nxitur zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare në një mënyrë që është e favorshme për punësimin e plotë dhe produktiv dhe punën e denjë për të gjithë.

3. Palët kujtojnë detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në OBT për të zbatuar në mënyrë efektive konventat e OBT-së që ata kanë ratifikuar dhe për të bërë përpjekje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme drejt ratifikimit të konventave themelore të OBT-së, si dhe konventave të tjera që klasifikohen si “të përditësuara” nga OBT-ja.

4. Shkelja e parimeve dhe të drejtave themelore në punë nuk mund të kërkojë ose ndryshe të përdoret si një avantazh krahasues i ligjshëm. Standardet e punës nuk do të përdoren për qëllime tregtare mbrojtëse.

² Kur puna referohet në këtë Kapitull, ajo përfshin çështjet e lidhura me Axhendën e Punës së Denjë, siç është rënë dakord në OBT-në.



Neni 36

Marrëveshjet shumëpalëshe mjedisore dhe parimet mjedisore

Palët riafirmojnë angazhimin e tyre për zbatimin efektiv në ligjet dhe praktikën e tyre të marrëveshjeve shumëpalëshe mjedisore në të cilat janë palë, si dhe zbatimin e tyre të parimeve mjedisore të reflektuara në instrumentet financiare të referuara në nenin 31.

Neni 37

Nxitja e tregtisë dhe investimeve që favorizojnë zhvillimin e qëndrueshëm

1. Palët do të përpiqen të lehtësojnë dhe nxisin investimet e huaja, tregtimin dhe shpërndarjen e mallrave dhe shërbimeve të dobishme për mjedisin, duke përfshirë teknologjitë mjedisore, energjinë e qëndrueshme të rinovueshme, mallrat dhe shërbimet efikase për energjinë dhe të etiketuara, duke përfshirë nëpërmjet trajtimit të barrierave jo-tarifore përkatëse.

2. Palët do të përpiqen të lehtësojnë dhe nxisin investimet e huaja, tregtimin dhe shpërndarjen e mallrave dhe shërbimeve që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm, duke përfshirë mallrat dhe shërbimet që i nënshtrohen skemave të tilla si tregtia e drejtë dhe etike.

3. Për këtë qëllim, Palët bien dakord të shkëmbejnë pikëpamje dhe mund të marrin në konsideratë, bashkërisht ose mbi baza dypalëshe, bashkëpunimin në këtë fushë.

4. Palët do të nxisin bashkëpunimin ndërmjet ndërmarrjeve në lidhje me mallrat, shërbimet dhe teknologjitë që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe janë të dobishme për mjedisin.

Neni 38

Bashkëpunimi në forumin ndërkombëtar

Palët do të përpiqen të forcojnë bashkëpunimin e tyre mbi tregtinë dhe investimet e lidhura me punën dhe çështjet mjedisore me interes të ndërsjellë në forumet përkatëse dypalëshe, rajonale dhe shumëpalëshe në të cilat marrin pjesë.

Neni 39

Zbatimi dhe konsultimet

1. Palët do të caktojnë entet administrative që do të shërbejnë si pika kontakti për qëllim të zbatimit të këtij kapitulli.

2. Një Palë, nëpërmjet pikave të kontaktit të referuara në paragrafin 1, mund të kërkojë konsultimet e ekspertit ose konsultimet brenda Komitetit të Përbashkët në lidhje me çdo çështje që lind sipas këtij kapitulli. Palët do të bëjnë çdo përpjekje për të arritur në një zgjidhje reciprokisht të kënaqshme të çështjes. Kur është e përshtatshme, në bazë të marrëveshjes së Palëve, ato mund të kërkojnë këshillim me organizatat ose organet ndërkombëtare përkatëse.

3. Nëse një Palë çmon që një masë e Palës tjetër nuk pajtohet me detyrimet sipas këtij kapitulli, mund t'u drejtohet konsultimeve sipas nenit 42, me përjashtim të fjalisë së fundit të paragrafit 3.

Neni 40

Rishikimi

Palët do të rishikojnë periodikisht në Komitetin e Përbashkët progresin e arritur për ndjekjen e objektivave të përcaktuar në këtë kapitull dhe të marrin në konsideratë zhvillimet ndërkombëtare përkatëse për të identifikuar fushat ku veprime të mëtejshme do të mund të promovonin këta objektiva.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë